



Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**2. AlbGarden shpk**

**NIPT K37513520N**

Vlera 221,228,900 (dyqind e njëzet e nje milion e dyqind e njëzet e tete mije e nenteqind) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**AlbGarden**”shpk u skualifikua duke qenë se nuk i plotësonte të gjitha kriteret si me poshtë:

Nga shqyrtimi I ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “A l b G a r d e n” shpk konstatojmë parregullsi në hartimin e ofertës ekonomike. Konkretisht, nga ana e operatorit ekonomik nuk është përdorur preventivi I publikuar nga Autoriteti Kontraktor në SPE. Gjatë hartimit të preventivit operatori ekonomik “A l b G a r d e n” shpk nuk ka përlogaritur normën e inflacionit të vitit të dytë, tretë, katërt dhe pestë, duke shmangur kërkesat e Autoritetit Kontraktor të specifikuara në formatin e publikuar në Shtojcën 7 “Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit” të DST,. Gjithashtu, është krahasuar vlera vjetore e preventivuar nga operatori ekonomik “A l b G a r d e n” shpk me vlerën vjetore të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor. Nga Krahasimi rezulton se vlera vjetore e deklaruar nga operatori ekonomik është më e lartë se vlera vjetore e përlogarit nga Autoriteti Kontraktor dhe për rrjedhojë do të kishim ofertë totale mbi fondin limit. Për këtë arsye, në mbështetje të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 92 “Shqyrtimi i ofertave” pika 2 përcakton se “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.” dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2 Autoriteti Kontraktor e konsideron ofertën e operatorit ekonomik “A l b G a r d e n” shpk të pavlefshme.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **GLAVENICA shpk Nipt K17710805A, me adrese** Fier Ballsh Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4, me vlere 219,028,517 (dyqind e nëntëmbëdhjetë milion e njëzet e tete mije e pesëqind e shtatëmbëdhjete) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar